



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 27.9.2012, e cila filloi në orën 11:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Prof.dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Fetah Salihu Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Afërdita Veliu, Skënder Reçica. Shefqet Sylejmani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja dhe Engin Beyoglu.

**Munguan:** Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, Liridon Restelica dhe Astrit Hasani.

**Morën pjesë edhe** drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të shoqërisë civile dhe të mjeteve të informimit.

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Engin Beyoglu, zv. Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete.**

**Kryesuesi** hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

**Sadri Ramabaja** tha se ky rend dite, sipas VV është shpërputhje me gjendjen dhe faktet që i ka imponuar realiteti i krijuar në ndërkohë, dhe atë për dy arsye, të cilat do ti potencoj këtu.

E para, kryesuesi i Kuvendit, për shkaqe që është i dyshuar, respektivisht i zënë në flagrancë si shkelës i ligjit, është arrestuar dhe ndodhet në paraburgim, ndaj tij tash është hapur procedura e hetimit. Lëvizja VV nuk pajtohet me këtë gjendje, prandaj insiston dorëheqjen e tij.

Në kërkojmë ndryshimin e këtij rendi të ditës, dhe shndërrimin e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme me një pikë të rendit të ditës të vetme, dhe atë “Informim mbi gjendjen e krijuar, pas arrestimit të Sami Hamitit, dhe korrupsioni në Komunë”.

**Kryesuesi** tha se sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 3, neni 47, thotë “anëtarët e Kuvendit të Komunës, mund të kërkojnë shtimin e një pike në rend të ditës, gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente, me rëndësi publike

**Prof.dr. Isa Mustafa, Kryetar** iu pergjigj z. Ramabaja, me ç'rast tha se " Në mendjen tënde nuk ka asgjë pozitive, mendja jote është mendje e prishur, e cila do ti burgoste të gjithë qytetarët e Kosovës, dhe ti nuk mund të flasësh për moralin. Me qenë ti i moralshëm, atëherë kishe qenë përfaqësues i partisë dhe i votuesve, që të kanë prurë në këtë Kuvend. Sa i përket çështjes së arrestimit të z. Hamiti duhet pritur organet e drejtësisë ta bëjnë punën e tyre, dhe ne pastaj do të sillemi sipas vendimit të organeve të drejtësisë.

Pas kësaj Sadri Ramabaja ka lëshuar sallën.

**U konstarua njëzëri se u aprovua ky**

## **R E N D I T E**

- 1. Miratimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2013 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore 2013- 2015;**
- 3. Propozimplani për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës, 2013- 2017;**
- 4. Informatë për përgatitjen e fillimit të vitit shkollor 2012- 2013;**
- 5. Caktimi i anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve";**
- 6. Propozimvendimi për shëpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës së Prishtinës;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**
- 8. Të ndryshme.**

**Pika e parë**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës.**

**Pika e dytë**

**Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2013 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore 2013-2015, në pika të shkurtëra e prezantoi Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Pronë.**

**Tefik Mehmeti** në emër të GP të LDK-së tha se ne e kemi analizuar këtë doracak të Kornizës afatmesme buxhetore 2013 -2015. Kjo kornizë është e punuar me standardet më të mira duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret financiare në fuqi. Është e thjeshtë, e qartë, dhe shumë e kuptueshme. Në fillim do e theksoj se ne plotësisht pajtohemi me projektet e parapara, meqë janë projekte të arsyeshme të nevojshme dhe të pritshme, të dala nga kërkesat e qytetarëve të Prishtinës.

Ky buxhet i paraparë për Komunën e Prishtinës, është i pa mjaftueshëm për zhvillimin dhe mbulimin e të gjitha kërkesave, gjithëherë në rritje të qytetit të Prishtinës. Këtë e them duke e marrë për bazë trendin e rritjes së numrit të banorëve, pavarësisht deklarimeve nga regjistrimi i popullsisë, të cilën rritje me çdo parametër mund ta shohim, me numër të

nxënësve, me ekonomi familjare, me shfrytëzues të shërbimeve publike, dhe me parametra tjerë. Problemet tjera, e sidomos rreth pagave janë të përshkruara në draft, këtu është fjala sidomos për

Drejtorinë e arsimit dhe të shëndetësisë. Ne vetëm mund të apelojmë që të bëhet një zgjidhje e përhershme, sepse këto janë probleme që përcillen në vazhdimësi. Me një buxhet të tillë në vitet e ardhshme do të jetë i vështirë plotësimi i nevojave gjithherë në rritje të popullsisë. Kjo ndërlihet edhe me pagat, sepse nuk parashihet ndonjë rritje e buxhetit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Në fund, e përgëzoj Kryetarin për punën e mirë, që po e bën, për shfrytëzimin sa më të mirë dhe më efikas të buxhetit komunal.

**Aziz Pacilli** në emër të GP të AKR-së tha se sa i përket buxhetit të Komunës së Prishtinës, them se shumica e projekteve, të cilat i ka propozuar edhe opozita, janë përfshirë në këtë buxhet.

Kisha një pyetje, të cilën e kam bërë edhe në KPF, me sa më kujtohet për pjesën rurale, janë caktuar diku 3 milion €, ndërsa këtu e kemi 2 milion e 280 mijë. Në GP është bërë pyetje mos është hequr një rrugë e fshatit Marec, e cila shkon deri te xhamia. Pra, kisha kërkuar një sqarim, për arsyen e zvogëlimit të mjeteve.

**Shemsi Veseli** në emër të GP të PDK-së fillimisht shprehi keqardhje, me ngjarjen dhe rastin, që ka ndodhur me kryesuesin, duke shtuar se ne e kemi thënë edhe publikisht nuk do të prejudiojmë asgjë, pajtohemi plotësisht me një pjesë të mirë të diskutimit të Kryetarit që janë organet e hetuesisë që do ta thonë fjalën e veë.

*Në emër të GP, distancohem për pjesën e fjalisës së kolegut Sadri Ramabaja, që realisht nuk ka as sens, as nuk ka shije që të thuhet se po vazhdon me filozofinë jugosllave, ose diçka tjetër ky Kuvend, se nuk ka kurrëgjë, sepse realisht është fyerje për të gjithë, dhe nuk i përket, pra, aq më shumë që një koleg t'i fyej këtu 50 e sa e mos të them gati 100 sa janë brenda edhe tjerë.*

*Mendoj se sipas nenit 38 të Statutit të Komunës është dashur ndoshta të jepet një informatë e shkurtë e Kryetarit se çka ka ndodhur, për hir të këshilltarëve dhe opinionit dhe do të mbyllet kjo çështje.*

Sa i përket Kornizës afatmesme të Komunës së Prishtinës dhe projekt buxhetit për vitin 2013, GP i PDK-së e kemi shqyrtuar dhe analizuar dhe mund të konstatojmë se kjo kornizë është në suazat e kornizës afatmesme, pra, që e parasheh edhe Qeveria në nivelin qendror, si dhe Ministria e financave, mund të them se i paraqet edhe disa projekte afatmesme zhvillimore dhe afa gjata të Komunës së Prishtinës.

Për shak të respektimit të afateve ligjore do të ishte mirë që në të ardhmen ky Kuvend i Komunës së Prishtinës, ta ketë mundësinë që 2-3 herë ta shqyrtojë ose ta debatton, projekt buxhetin, gjegjësisht edhe qarkoren për hir të pasurisë më të madhe, pra, thjeshtë sa i përket projekteve.

Çështja e dytë është se konsideroj që po mungon nganjëherë krahasimi i raportit sa i përket buxhetit të pozicioneve shpenzuese, bile kemi mundur ta bëjmë brenda 9 muajve, që ta gjejmë e ta bëjmë një krahasim për sa ka mundur, cilat janë tendencat, pra mungon kjo analizë, mungojnë vlerësimet mbi nevojat nganjëherë edhe reale, prioritetet e objektivave buxhetore, që është mirë ti përcjellim, pra, jo veç në aspektin e grafikës, por edhe me analiza në aspektin tekstual. Ana e të hyrave publike duhet të pasqyrohet jo vetëm në mënyrë tabelare, duhet pasqyruar edhe strukturën e burimeve vetanake, pra, këtu në këtë rast është pa pjesën e analizës, mbi argumentet për një strukturë të tillë.. Duke e pasur për bazë se jemi në proces të legalizimit, po ashtu të objekteve të ndërtimit, se aty do të ketë të hyra,

Do të ishte mirë të planifikojmë për kornizën afatmesme buxhetore. Sa i përket pozicionit të tatimit në pronë, konsideroj që është mirë ndoshta të mendojmë si Kuvend Komunal për të gjeneruar mjete edhe më shumë, sidomos nga objektet banesore, që tatimohet dhe sipërfaqja e tyre etj. Megjithatë jemi ihtar të asaj që t'i shtyjmë qytetarët në sistem.

Me gjithë këto vlerëjtje dhe sugjerime, GP i PDK-së do ta votojë këtë buxhet për miratim .

**Prof.dr.Isa Mustafa** *tha se e vlerësoj këtë që z. Veseli e shtroi lidhur me informimin për arrestimin dhe mbajtjen në procedurë paraprake të kryesuesit të Kuvendit. Nuk kemi ndonjë informatë të veçantë, jashtë atyre, që janë dhënë në medie, as unë si Kryetar i Komunës, as Komuna, në bazë të cilës ne to tiu informonim se çfarë ka ndodhur. Te unë kanë ardhur ditën që e kanë bërë kontrollimin e zyrës përfaqësuesit e EULEX-it, më kanë informuar, i kanë respektuar të gjitha procedurat ligjore, kanë thënë që ne do të hyjmë e bëjmë një kontroll, por pasi që ta informojmë, dhe ta marrim pëlqimin e Kryetarit të Komunës, dhe e kanë bërë në bazë të gjitha procedurave. Unë i kam pyetur se çka është në pyetje, ata më kanë thënë se nuk kanë mandat për të më informuar më tutje, por vetëm për me ti shfrytëzuar të drejtat, të cilat i kanë në bazë të ligjit, dhe ato të drejta i kanë shfrytëzuar. Ajo që unë mund të ju them juve, që unë si Kryetar i Komunës nuk e kam asnjë informatë, që diçka ka ndodhur në Komunë. Pra, nuk e kam asnjë informatë e as që kam pasur ndonjë inicim të një procedure për ndryshim të ndonjë plani rregullues, ose për një ndryshim të ndonjë pjese për ndonjë plan rregullues, në bazë të cilës do të plotësohej ajo çfarë është dhënë në media, se dikush ka pasur për qëllim ta ndryshoj, të jap leje leje, pra, kurrë nuk ka pasur këtu në Komunë, nuk është kryer asnjë veprim brenda, nuk ka pasur asnjë kërkesë te unë meqenëse me mua si Kryetar i Komunës gjithnjë bëhet përgatitet rendi i ditës për Kuvend.*

**Shefqet Sylejmani** *në emër të GP të AAK-së fillimisht tha se jemi pak të goditur nga fjalët e rënda që po bien në Kuvend. Si GP së pari distancohem nga vlerësimet e kolegut tone, që në momentin e caktuar edhe e lëshoi mbledhjen, konsiderojmë se është njerëzore njeriu të mbrohet, po është shumë burrërore edhe më tepër se njerëzore, njeriu t'i mbrojë të tjerët nga vetvetja, dhe kjo nuk po ndodhë nga z. Sadri Ramabaja , ai ka të drejtë të bëjë pyetje, ka të drejtë edhe të propozoj që të vihet diçka në rendin e ditës, por jo edhe t'i imponoj qëndrimet e veta.*

*Në anën tjetër, e përkrahim plotësisht fjalën e Kryetarit z. Isa Mustafa në fillim të kësaj seance , përndryshe edhe kjo pjesë që tani në kërkesë, jo në kërkesë por në sugjerim të z. Shemsi Veseli.*

Sa i përket buxhetit të Komunës dhe kornizes afatmesme buxhetore, si GP, e kemi shqyruar dhe analizuar, është një material i mirë , andaj përgëzimet tona edhe për Drejtorinë e Financave, dhe në dorën e fundit të Kryetarit dhe të nënkryetarit në këtë, prandaj nuk po kursehem edhe këtu të them, vërtetë kështu i ka hije Prishtinës të punojë me buxhetin edhe me kornizën. Në veçanti kur lexohet pjesa tekstuale e këtij materiali, shihet se në mënyrë shumë besnike autoktone, janë dhënë të gjitha përshtimet e veprimeve, që janë bërë në përgatitjen dhe sajimin e kësaj kornize dhe të buxhetit.

Si GP propozojmë që të bëhet një prerje e një afati për kamatë, kur ato kamata do të ishte mirë të eliminohen, sepse me këtë mendoj se do të lirohet një pjesë e qytetarëve, të cilët e kanë këtë barrë. Për fat të keq dihet që janë të nivelit shumë të lartë nëpër banka, prandaj Komuna e Prishtinës në këtë drejtim ta kursejë pjesën e obliguesve të vetë nga kjo çështje.

Në këtë drejtim po e them edhe me këtë kornizë afatmesme të buxhetit për vitin 2013, nuk e di sa do të jemi në nivel të asaj çka dëshirohet, dhe çka dëshirojmë ne si Asamble e Komunës së Prishtinës këtu, edhe për çështjen e arsimit , shëndetësisë, dhe qe besa edhe për nivelin e shërbimeve publike, për të cilat Prishtina është një deti në kuptimin e nevojave për këtë sferë, dhe megjithatë këto janë do sugjerime të cilat konsideroj, që janë të nevojshme që secili në GP, por edhe në nivel qendror të sugjerohet.

Ne si GP e përgëzojmë edhe njëherë drejtorinë dhe të gjithë të tjerët që e kanë dhënë kontributin e vetë në këtë material, dhe ne do ta përkrahim, pa kurrfarë rezerve për miratim.

**Shefki Gashi** në emër të GP të LDD-së fillimisht shprehu keqardhje për veprimin dhe deklarimin e z. Ramabaja rreth rastit të Kryesuesit të Kuvendit. Gjithashtu vërejtje bëri edhe për veprimin që e bënë mjetet e informimit për xhirimin dhe inqizimin jasht salles së Kuvendit.

Sa i përket buxhetit, jam pjesëmarrës aktiv në përpilimin e kësaj kornize buxhetore, kështu që edhe kam disa vërejtje.

Shtëpia e shëndetit të Xhamia e Llapit atje është e ndërtuar shumë moti atje, është shumë afër rruge, ka zënë shumë sipërfaqe. Aty nuk mund të kryhen kurrfarë shërbimesh, prandaj unë kisha propozuar z. drejtor i shëndetësisë, që ajo të rrënohet të shkohet me kate me kate poshtë dhe lartë, të nxirret një një QMF e mirë, dhe në pjesët tjera të ketë edhe shërbime tjera aty çfarë ka nevojë.

E dyta për z. Ridvan kisha dashur që ta shikoni në mënyrë eksperti që edhe te ish Slovenija Sporti, të bëhet një rreth dhe për këtë propozim kisha kërkuar që në seancën e radhës përgjigjen nëse nuk mundesh bënë ose nuk bënë teknikisht.

Edhe e ruaj të drejtën z. kryetar, që të kërkojmë ndonjë ndryshim më vonë nëse teprojnë mjete ose punëkryesi nuk mund t'i kryejë punët, ose nuk don ti kryej, ose ka pengesa në çështjet pronësore, pra atë të drejtë ta ruajmë ne si Kuvend, që ti bartim ato mjete në një pozicion tjetër.

**Feti Mehdiu** në emër të GP të Partisë së drejtësisë tha se shprehë keqardhje që fatkeqësisht ballafaqohemi me një keqpërdorim të demokracisë.

Për pikën e rendit të ditës, vetëm të ju përkujtuar që kamë marr pjesë si shef i GP ku kemi biseduar edhe për mbylljen e asaj shtëpie të shëndetit në Qendren e studentave, andaj dua ta shtojë vetëm këtë se çka është puna me mbylljen e asaj shtëpisë së shëndetit, a klinikë a çka është ajo, pasi që është biseduar që ajo doemos të aktivizohet sa më shpejtë. Gjithashtu ishin edhe disa biseda tjera që i referoheshin arsimit. Ne do ta përkrahim këtë propozim të projektbuxhetit, natyrisht përherë ka vend, përherë ka mundësi të bëhen më mire. Ne kemi edhe njëfarë përgjegjëse në emër të atyre që na kanë pru këtu, por Prishtina si kryeqendër pengohet nga ato organe tjera që atje sjellin ligje, andaj dhe ne duhet ti zbatojmë, prandaj Prishtina nuk mund të jetë më mire me ato ligje ekzistuese..

**Mustafë Krasniqi** tha se për buxhetit për vitin 2013 dhe kornizën afatmesme buxhetore, qëndrimin dhe përkrahjen e dha z. Tefik Mehmeti, mirëpo si shef i GP të LDK-së dhe në emër të këshillëtarëve të GP distancohemi nga fjalët fyese të z. Sadri Ramabaja, të cilat vijnë në drejtim të kryesuesit, por edhe në drejtim të, të gjithë neve.

**Kimet Zeqa** tha se Ambulanca të "Xhamia e Llapit" ka ekzistuar që nga viti 1964, andaj propozoi që në qoftë se ka mundësi ligjore, të ndërtohet një ambulancë e mirëfilltë e cila i plotëson kushtet.

E dyta, Ambulanta të Qendra e studentëve është më se e domosdoshme të funksionojë, sepse ambulanca veç ekziston, pasi që edhe unë kam punuar ety. Do të ishte shumë mire që për nevoja të studentëve në të ardhmen të funksionojë gjinekologu, mjeku, laboratorit, stomatologu.

**Naim Makolli** tha se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa mund të thuhet dhe të sqarohen shumë çështje që ato të mos na servohen në Kuvend, pasi që po na marrin kohë, pra, është mirë që KPF-ja t'i mendon mirë këto gjëra, se nuk duhet të vijnë këtu pastaj të akuzojnë të tjerët njerëzit pa autoritet, pa imunitet të votes, andaj dhe për këtë e përkrahi shumë diskutimin e kryetarit rreth kësaj çështje.

Rreth buxhetit dua të them se kishte një rritje të buxhetit në krahasim me vitin e kaluar, e përgëzoi drejtorinë dhe drejtorin përkatëse.

Për diskutimin e shefave të GP do të ishte mirë që edhe atyre tua masim kohën sepse po na marrin shumë kohë, andaj dhe nuk po kemi diskutime konkrete prej njerzëve, që duhet me pasë.

Shumë projekte, konkretisht rrugë në zonat rurale në këtë vit do të mbesin pa përfunduar, andej kisha kërkuar që vitin e ardhshëm, këto rrugë ta përfundojnë sa më shpejtë. Apeloj që për zonat rurale të rritet, dyfishohet planifikimi i buxhetit për vitin 2013, sepse në atë formë i ndihmojmë qytetarët e Komunës së Prishtinës.

**Besa Halim-Zagragja** tha se është hera e dytë kjo që po kërkojë që mënyra e informimit të qytetarëve për diskutimet publike të jetë më e zëshme, më transparente, sepse në qytetin e Prishtinës ka shumë qytetar profesionist të cilët do të kishin mundur ta japin kontributin e çmueshëm për punën, buxhetin dhe për gjithçka që do ti vlente punës së këtij Kuvendi. As vetë ndoshta nuk e di shumë mirë se ku qiten shpalljet, çfarë formati kanë, çfarë madhësie, sa janë të dukshme, prandaj kisha kërkuar që thirrjet për qytetarët, për diskutime publike për çfarëdo çështje qoftë të jenë më të zëshme, më të dukshme, më publike.

*Për vërejtjet dhe sugjerimet, që u dhan nga parafolësit për buxhetin e komunës për vitin 2013 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore 2013- 2015, Prof.dr.Isa Mustafa, Kryetar dhe sqarime të nevojshme.*

## **Njëzëri u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2013 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore 2013- 2015.**

### **Pika e tretë**

**Lidhur me Propozim planin për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës, 2013-2017, kryesuesi** tha se ky plan është në përputhje me Planin strategjik zhvillimor të arsimit në Kosovë 2011-2016, dhe është në përputhje me kornizën e kurikulit dhe Ligjit për arsim të Kosovës.

**Flamur Shala** në emër të GP të LDK-së tha se e përkrah për aprovim këtë Draft plan. Janë disa arsye pse LDK e përkrah këtë Plan të zhvillimit të arsimit në Komunën e Prishtinës.

1. Prishtina ka nevojë për një plan të detajuar të identifikimit të kërkesave dhe të projekteve për zhvillimin e arsimit në kryeqytet;
2. Identifikimi i nevojave për zhvillimin e arsimit të kryeqytetit, përmes këtij Draft plani zhvillimor në 5 vitet e ardhshme, nxjerrë përpara sfida në fusha të caktuara arsimore, objektiva strategjik për realizimin e vizionit, për zhvillimin e arsimit të Prishtinës, masat që duhet marrë bashkë me aktivitete, afatet, bartësit e realizimit të projekteve konkrete, dhe koston orientuese të realizimit të projekteve sipas këtij Plani zhvillimor;
3. Plotësimi i nevojave në 5 fushat e caktuara, është harmonizuar me masat dhe aktivitetet, që duhet zhvilluar, si dhe me afatet kohore, dhe koston orientuese të projekteve konkrete për realizimin e këtij plani.

Treguesit e paraqitur si arritje e mundshme e realizuar e objektivave janë reale. Shihet po ashtu se në këtë Draft plan hartuesi ka pasur parasysh organizimin e sistemit arsimor pasuniversitar, mbështetur në ligjet që e mbulojnë këtë fushë dhe ka pasur parasysh dokumentet buxhetore përkatëse si dhe trendet e zhvillimit të buxhetit komunal në favor të realizimit të këtij plani.

Po ashtu dokumenti ka pasur parasysh dy dokumente strategjike zhvillimore të nivelit qendror, Planin strategjik të zhvillimit të arsimit 2011-2016 dhe Kornizën e kurikulës së

arsimit para universitar. Dokumente këto që mund t'i kenë dhënë kahun e duhur zhvillimit të arsimit në Republikën e Kosovës.

Ky draft duke qenë i përgatitur mirë për aprovim, si një plan zhvillimor i ardhshëm, pra në 5 vitet e ardhshme i aprovuar nga ky Kuvend përbën njërin nga dokumentet e rëndësishme të zhvillimit të Komunës në përgjithësi dhe në kuadër të kësaj të zhvillimit të arsimit në veçanti, andaj GP i LDK-së e miraton njëzëri.

**Aziz Pacolli** në emër të GP të AKR-së tha se këtë propozim plan e kemi lexuar, dhe analizuar. E përgëzojm ekipin që e ka punuar Planin zhvillimor të arsimit. Vërtetë është një kërkesë prej GP të AKR-së si të ofrohen shërbimet më cilësore në arsimin e Prishtinës. Ne mendojmë se duhet të formohet një grup i këshilltarëve komunalë, apo inspektorëve komunalë, që kanë qenë, të cilët do të prezantojnë në orët e mësimin, ku do të vlerësojnë punën e mësimit dhe për realizimin e plan programeve. Ne mendojmë se aty çalon faktikisht arsimit në përgjithësi.

Kërkojmë që në të ardhmen, pra në fund të vitit shkollor të jetë një informatë rreth realizimit të plan programeve të mësimit dhe nëpër shkolla.

E përkrahim si GP këtë plan zhvillimor për miratim.

**Besa Halimi-Zagragja** në emër GP të PDK-së tha se une kam qenë pjesë e hartimit të këtij Plani strategjik për arsimin e Komunës së Prishtinës dhe duke qenë aty kam parë gjithë zhvillimin nëpër të cilin ka kaluar ky dokument. Ky Plan parasheh zgjidhjen dhe udhëheqjen e problematikave arsimore për këtë periudhë kohore të shumë problematikave, mirëpo nuk do të thotë se i përfshin strikt të gjitha ato që ne i shohim në përditshmërinë tonë, sepse kemi limite të ndryshme, qoftë buxhetore apo edhe të natyrave tjera, të cilat nuk mund të tejkalohen për një periudhë qoftë 2-3 apo 5 vjeçare apo edhe më gjatë. Kështu që në Planin strategjik p.sh, nuk është bërë ndoshta më e mira për personat me aftësi të kufizuara, ose për mbikëqyrjen e institucioneve private, ose çështjeve tjera që mund të kenë rëndësi të madhe për arsimin, por kryesisht është një plan, i cili do të ndikojë mjaftë në cilësinë e mësimit dhe në mbarë procesin mësimor.

Kështu që pa dyshim që e përkrahim dhe sigurisht që mirëpritën të gjithë ata që do të kontribuojnë në zbatimin dhe plotësimin e tij.

**Shefqet Sylejmani** në emër të GP të AAK-së tha se këtë dokument e kemi shqyrtuar dhe konsiderojmë që është bazë e shkëlqyer për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës dhe ashtu siç na sugjerohet të jemi model për të tjerët në nivel të Kosovës. Një problem paraprakisht duhet ta themi do të jenë mjetet, se a do të lejojnë implementimin 100% e këtij plani apo jo. Urojmë që me një riorganizim dhe me një decentralizim të mundësisë financiare nga niveli qendror në nivelin komunal që do të mundësohet edhe kjo dhe t'ia dalim.

Janë disa faktorë që ndikojnë në realizimin e këtij plani, Duke filluar prej zhvillimit të bazës ekonomike të mirëqenies së përgjithshme shoqërore, kulturës, edukimit, etj. Në këtë drejtim konsiderojmë që edhe me këtë kornizë edhe me ligje do të ishte mirë që të parashihet eliminimi i të gjitha vështirësive si në një mënyrë apo në një tjetër mënyrë, në mënyrë direkte, apo indirekte ndikojnë në këtë tash për tash, dukuri e lehtë e shprehur, por që mund të jetë e dëmshme në të ardhmen. Në anën tjetër mendoj se kualiteti krahas kuantitetit që e kemi në shkolla duhet të ngritet.

Problem tjetër e konsideroj çështjen e sigurisë. Mendoj se në këtë drejtim duhet të ndërmerret diçka konkrete, në ashpërsimin e masave ndëshkuese ndaj keqbërësve, ndaj atyre që e prishin rendin, e prishin disiplinën atyre që ua bëjnë jetën e ithtë si nxënësve të shkollës fillore e sidomos të mesmeve në Komunën e Prishtinës.

Urojmë që ky dokument ta gjejë implementimin e tij që nga fillimi i jetësimit të tij, pas aprovimit të sotshëm për çka ne si GP do të pajtohemi që ta miratojmë.

**Besa Rafuna** ne emer te GP te LDD-së tha se përkrahim për aprovim këtë Draft plan. Njëherësh e falënderojmë edhe e përgëzojmë grupin e planifikimit për punën e shkëlqyer të bërë. Vetëm se urojmë që ky plan të realizohet në praktikë, sepse ky plan do të varet edhe nga mundësitë buxhetore.

**Feti Mehdiu** në emër të GP te Partis se drejtesisë tha se e përgëzon gjithashtu grupin që ka punuar këtë material, dhe që na ka ofruar, ka shumë detaje besoj se është shumë i plotë. Megjithatë duhet shtuar diçka se Komuna duhet të shohë mundësinë se në cilat shkolla sa vende të zbrazëta ka, nxënës që nuk ka në shkollat profesionale sa duhet etj. Është mirë të shikohen ato mundësi, që ne ato shkolla profesionale që nuk ka mjaftë nxënës, të ketë njëfarë burse, një stimulim për nxënësit që të shkojnë në ato shkolla. Tjetra që mendoj do të ishte që përveç investimit në instalimin e kamerave me rëndësi do të ishte bashkëpunimi mesues-prind, andaj te kihet parasysh kjo si dhe marrjen e masave ndaj atyre që e pengojnë mbarvajtjen e mësimit. Janë disa masa që janë përdorur nëpër shkolla, unë jam ithtar i asaj që ato prapë të përdoren.

Si sugjerim e kam që ky program do të ishte shumë i mirë, po të kihen parasysh edhe këto gjëra, të cilat i parashtrova.

**Sofije Killokoqi** tha se ne këtë plan ka vetem pozitive që meritojnë çdo lëvdatë. Do ta theksoja një gjë që vërtetë, ne gjithherë na shkon të themi financim, financim, por t'i lëmë mjetet financiare, por të jemi të ndërgjegjshëm, të punojmë ashtu siç na ka hije dhe qysh na flet pedagogjia. Më duket shumë më e arsyeshme ta gjejmë një fjalor të mirë dhe gjithkujt mos t'i jepet ditari i punës. Të kemi parasysh kush e kap ditarin për të punuar, këtë po e them, e aty nuk na duhet financim, por na duhet një krahasim, një punë e shkëlqyer e të gjithëve kush është përgjegjës për ta lejuar çdo punë e çdo kujt.

E përkrahi këtë plan dhe shumë lëvdata kam për këtë punë që e kanë bërë, duke filluar prej drejtorit të arsimit dhe të tjerët.

**Rexhep Mustafa** tha se kam dy sugjerime: e përkrahu z. Pacolli që të percillet puna e mësuesve dhe arsimtarëve nga ana e një inspektorati të pavarur, kurse e dyta mendoj se nuk guxojmë ne të presim derisa të rregullohet çështja materiale e disa mësuesve që ose janë të sëmurë, ose i ka lëshuar kujtesa e të presim deri sa të rregullohet çështja materiale e tyre do të bëhet vonë për ata nxënës që i mësojnë. Do të kërkoja që të gjendet një zgjidhje për të gjithë ata mësues dhe profesorë sepse flitet që ka dhe nuk i plotësojnë kriteret për mësimdhënie, sepse do të ketë shumë pasoja për gjeneratat që i përcjellin.

**Halim Halimi** drejtor i Drejtorisë së Arsimit tha se falenderon ekipin ose grupin planifikues, i cili ka punuar me një përkushtim shumë të madh në paraqitjen e një Projekt plani zhvillimor të arsimit të Prishtinës, duke përfshirë arsimin parafillor, fillor, të mesëm, edhe të gjitha palët me interes duke e përfshirë shoqërinë civile, përfaqësuesit e Ministrisë së arsimit, shoqatat e veteranëve etj. Për të gjitha ato vëreje plotësime dhe sugjerime, të cilat u dhan nga te pranishmit dha sqarime te nevojshme.

**Besa Halimi-Zagragja** tha se meqë u ngrit çështja e mbikëqyrjes së mësimdhënësve, kisha dashur të jap një informatë të shkurtë, se si planifikohet kjo mbikëqyrje në një periudhë shumë të afërt të arsimit.

Në ministri është krijuar njësi për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, që do të kontribuojë procesit të licencimit të mësimdhënësve. Këshilli shtetëror për licencimin e mësimdhënësve e ka hartuar një dokument dhe disa instrumente, të cilat i vihen në shërbim kësaj njësie dhe e cila do të fillojë matjen, vlerësimin e performancës së



mësimdhënësëve në gjithë vendin dhe udhëhiqet nga sektorët e inspektimit që janë 7 në gjithë Kosovën. Besoj se shumë shpejt do të kemi një mbikëqyrje shumë më të madhe për mësimdhënësit për cilësinë e ndoshta do të urojmë që të kemi edhe mbulesë buxhetore për largimin ose kompensimin e mësimdhënësve që janë në gjendje jo të mirë shëndetësore.

**Njëzëri u miratua Plani për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prishtinës, 2013-2017.**

**Pika e katërt**

**Për Informatën rreth përgatitjes së fillimit të vitit shkollor 2012 – 2013, në pika të shkurtëra informoi Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.**

**Vjollca Rizani** në emër të GP të LDK-së tha se e përkrahim këtë informatë e cila ka të bëjë me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2012 – 2013 me urimin që nxënësit së bashku me arsimtarët të kenë shëndet dhe punë të mbarë.

**Aziz Pacolli** në emër GP të AKR-së shtroi pyetjen, se dihet që shumica e nxënësve të shkëlqyeshëm kanë mbetur pa u regjistruar nëpër shkollat të cilat kanë synuar ata. A ka përfunduar orientimi i tyre dhe a ka filluar mësimi i gjithë nxënësve dhe sa kanë mbetur pa u regjistruar nëse ka mbetur ndonjë nxënës.

**Shemsi Veseli** në emër të GP të PDK-se tha se e falënderoj drejtorin normalisht që ka edhe gjëra tjera që është dashur të përfshihen ndoshta edhe në kuadër të kësaj informate sidomos që janë disa gjëra shqetësuese i kam përmendur edhe në Komitetin për Politik dhe Financa. Mua më ka shokuar rasti që ka ndodhur me nxënësit e gjimnazit “Sami Frashërit” në ekskurzion edhe zënien e 2kg drogë marihuan në Shqipëri. Është njëra prej shqetësimeve që edhe ne si prind që po rritim fëmijë edhe sendet tjera që të ketë një kontrollë jashtëzakonisht të fuqishme në këtë aspekt për arsye se kur po flasim për siguri patëm kanosjen e punëtorëve të arsimit të shkolla teknike gjegjësisht pjesa e gjimnazit etj.

Çështja e dytë, që unë do ta ngriti në kuadër të kësaj informate do të ishte mirë që për hir të sigurisë së nxënësve të shihen zëra buxhetor për një mbikalim në rrugën “Vëllezërit Fazliu”.

Çështje e tretë e që vlen të theksohet, konkretisht rreth sigurisë së nxënësve është edhe vendosja e kamerave që do të ndikonte shumë në aspektin psikologjik.

Çështja tjetër që ishte dashur ta bisedonim realisht do të ishte edhe çështja e mungesës së ujit në disa shkolla. Dhe në fund kam disa vërejtje nga qytetarët gjegjësisht nga prindërit se ushqimit në çerdhet e parashkollorëve nuk është duke u përmbajtur në bazë të kontratës.

**Shefki Gashi** në emër të GP të LDD-së fillimisht kishte vërejtje rreth të dhënave në tabelë për numrin e nxënësve të regjistruar në klasën e parë dhe për këtë kërkoi sqarim. Shqetsim tjetër është se në institucionet parashkollore sipas të dhënave në tabelë, numri i të regjistruarve në institucionet parashkollore është shumë i vogël, andaj për këtë çështje kërkoi që në këtë drejtim të punohet më shumë që ky numer të rritet. Uroj punë të mbarë dhe sukses në këtë vit shkollor, rend e disiplinë etj.

**Feti Mehdiu** në emër të GP të Partisë së drejtësisë tha se për ato paralele që kanë pak nxënës duhet të mendohet si është më mirë a ti qojmë në shkolla tjera apo me bërë përpjekje të rrinë në atë shkollë që janë për shkak se sot nesër janë 3-4 vitin tjetër mund të bëhen 7-8 ose 10, nëse i çojmë në shkollat tjera mandej më nuk fillojnë aty.

**Mejreme Berisha** në emer të GP të AAK-së fillimisht tha se çfarë mund të bëjë Komuna e Prishtinës me 8 çerdhe publike, me 12 shkolla të mesme dhe me 41 shkolla fillore. Si Komunë jemi në rend të parë shumë keq për paralele, sepse në gjimnazin tonë kemi deri në 47 nxënës në paralele, edhe këtu kuptohet se qëndron problemi. Në këtë informatë kishte qenë mirë të na paraqitet struktura gjinore dhe kombëtare, si pasqyrë.

Sa i përket ekskursioneve tha se a do të kishte mundësi që mos të orientohemi vetëm në një vend pasi që ka edhe hapësira tjera gjithshqiptare që janë të shkëlqyera dhe të pa parapara.

Pastaj sa i përket sigurimit gjithmonë kam qenë një ithtare e sigurimit nga SHPK-ja nëpër shkolla që të jetë pak më haptas ma e fuqishme.

*Per vërejtjet, sugjerimet dhe plotësime e dhëna nga parafolësit, arsyeshmërinë e dha Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim.*

**U konstatua se njëzëri u perkrah Informata për përgatitjen e fillimit të vitit shkollor 2012- 2013.**

### **Pika e pestë**

**Lidhur me caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale “Stacioni i Autobusëve”, në pika të shkurtëra informoi Agim Salihu, shef i Zyres ligjore.**

**Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale “Stacioni i Autobusëve”;**

### **Pika e gjashtë**

**Lidhur me Propozimvendimin për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës së Prishtinës, Agim Gashi** tha se këto automjete kanë qenë të parkuara në të ashtuquajturën parkingun e kompanisë “Gollaku”. Me një vendim të gjykatës, Komuna urdhërohet të marrë ato vetura dhe ti dislokojë në parkingun e vet me qëllim që të lëshohet prona, e cila tash më është privatizuar në atë pjesë ku ka ekzistuar parkingu paraprak. Të gjitha ato vetura janë jasht funksionimit, janë mbetje hekurash.

**Njëzëri u miratua Vendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve në pronësi të Komunës së Prishtinës.**

### **Pika e shtatë dhe e tetë**

#### **Pyetje, pergjigje dhe të ndryshme**

**Mejreme Berisha** tha se në fakt kam bërë disa herë një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pra është fjala për rrugën “Dëshmorët e Marecit” e cila është një rrugë shumë e ngushtë, nuk është ajo rruga kryesore, por unë kam bërë pyetje për kthesat anësore. Kam kërkuar që kthesat që janë prej rrugës “Dëshmorët e Marecit” që dalin në rrugën “Isa Kastrati” të behen njëkahëshe, sepse aq janë të ngushta sa që nuk ka ditë që nuk ndeshen kerret aty ca vinë prej rrugës “Isa Kastrati” e tjerat dalin prej “Dëshmorët e Marecit” a jeni duke më kuptuar drejtor se ku është problemi, jo rruga kryesore. Ju më kemi thënë apo kush ma ka kthyer përgjigjen.

**Agim Gashi** tha se përgjigja është kthyer nga zyrtari, që është kompetent për këtë çështje. **Hetem Kupina** para se ti shtroje pyetjet për drejtoritë përkatëse, fillimisht ngriti shqetësim për mos prezencën, gjegjësisht mos praninë e drejtorëve, duke shtuar se ata janë të obliguar të dëgjojnë deri në fund zërin e anëtarëve të Kuvendit, por le të kaloje siç po kalon.

#### **-Pyetje për Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sportit**

Bardhoshi me numër të banorëve 8731 veta deri në fillim të vitit 2011 ka pas shtëpi të Kulturës që shumë kush e ka pas lakmi, ka pas Bibliotekë edhe dy fusha të sportit, sot asnjërin nga këto nuk e ka. Për këtë çështje kërkohet që përgjigja të më jepet me shkrim.

#### **-Për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale**

Cili është opinionimi i juaj z. drejtor për gjendjen momentale sa i përket rrjetit të kanalizimit në Bardhosh? Kam dëshirë që përgjigjen të ma japni me shkrim.

#### **-Për Drejtorinë e Administratës**

Në emër të punëtorëve të sigurimit sipas tyre dikur në të kaluarën rrobat gjegjësisht u janë siguruar për çdo vit. Gjithashtu ata thonë se dhe puna jashtë orarit të punës u është kompensuar. Cila është përgjigja e drejtorit të drejtoratit në fjalë?

#### **Aziz Pacolli, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale**

Kur do të bëhet trotuari në Sofali nëse është në projekt dhe kur do të vizitohet Taukbashqja, ku punëkryesi ka një projekt tjetër ndërsa Komuna ka projektin tjetër.

Flas për shetitoren, e cila ndërpritet pikërisht në gjysmë të Taukbashqes e nuk vazhdon rrugës teposhtë që e ka deri te lojërat e pastaj te bashkëngjitet me rrugën e asfaltuar.

#### **Rexhep Mustafa, pyetje për Drejtorinë e Shërbime Publike.**

A do të kishte mundësi që në rrugën "Vëllezërit Fazliu" që prej "Sharbanëve" deri te "Xhamia e Llapit" prej mëngjesit deri në orën një të funksionojnë dy traka me hy në qytet, ndërsa prej ores, pra pas dite ana e djathtë që shkon për Podujevë të funksionojnë dy traka, ndërsa për hyrje në qytet të jet vetëm një.

Autobusat ndalen vend e pa vend edhe kombit, ata ndalen për midis rrugës, po është shumë problem edhe para dite edhe pas dite.

Nëse ka mundësi ti caktoni stacionet e autobusëve por ti caktoni aty ku ka hapësirë më të gjerë para lokaleve që mos te e bllokohet rruga.

Sa i përket shpejtësisë, ne si Komunë nuk mund të ndërmarrim asgjë, duhet bashkëpunimi me policinë. Unë endem dy herë në ditë kur nuk kam parë që policia e matin shpejtësinë deri tek shkolla atje lartë. Pa sanksione gjithmonë do të kemi fatkeqësi. Kërkohet që të merren masa në parandalimin e pasojave të mundshme.

Lidhur me shqetësimin e z. Rexhep Mustafa, **Agim Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dha sqarime të nevojshme.

**Shaip Hajrizi** tha se kam një pyetje dhe për fat të keq një informatë të dhimbshme.

Pyetja është sepse jam i obliguar nga disa qytetarë ta bej këtë pyetje lidhur me një vendim të Komunës para një kohe që ka ndodhur dhe që kanë dal ta rrenojnë xhaminë në Matiqan, ngjarje e cila ka qenë i informuar edhe opinionimi se jka ka ndodhur.

Sipas informatave nga Bashkësia Islame thuhet se të gjitha dokumentacionet e plotë që duhet ti dorëzojnë në Komunë i kanë dorëzuar qysh para një viti e gjysmë. Prandaj mirë është që në këto vendime sidomos nëpër disa objekte që janë të ndjeshme te kemi pak kujdes dhe krejt çka kërkohet nga ata kërkohet një takim për te prej kësaj shtate.

Informata që thash për fat të keq është e dhimbshme ju e dini që unë disa herë kam kërkuar ndoshta kam qenë edhe i tepërt për një pengesë pikërisht për aty ku u fol edhe nga baci Rexhë prej policisë e deri te Sharbant që ka pas përpara shumë aksidente e ajo nuk u bë, dhe informata, të cilën me keqardhje duhet ta them aty ka edhe një viktimë është personi Idriz

Maqastena, i cili e ka humbur jetën pikërisht nga shpejtësia e madhe e automjeteve, e ndoshta edhe për shkak të kësaj pengese që nuk është vendosur.

**Shefqet Sylejmani** fillimisht tha se plotësisht solidarizohem me qëndrimet e parafolësve që në pikën pyetje dhe përgjigje dhe në të ndryshme ose le të jenë edhe drejtorët ose nuk ka efekt ne te jemi ketu, dhe në anën tjetër ne kemi pak faj vet se e kemi degraduar këtë pikë të rendit të ditës edhe njëherë edhe tjetër. Propozoj që në të ardhmen për këto dy pikat pyetje dhe përgjigje dhe të ndryshme ose të jemi të gjithë komplet ose le të shtyhen këto pika dhe le të informohet kryetari i komunës që këto dy pika u shtynë në mungesë të kuorumit, dhe mos ti degradojmë pikat, shumë çështje janë nganjëherë shumë më të rëndësishme se ato që i kemi në rend të ditës, nën të ndryshme dhe pyetje e përgjigje.

Në pikën të ndryshme me përgjigjet nuk jam i kënaqur së pari nuk më janë dhënë përgjigjet nuk po i flas drejtoratet me emra.

E dyta, e kam një kërkesë në emër të qytetarëve për udhëkryqin ish Tjegullorja- Ministri e Shëndetësisë dhe Tophane – Varreza ky është udhëkryqi që paraqet rrezik permanent edhe për qytetarë, d.m.th për këmbësore, por edhe për komunikacion.

Do të ishte mirë që në këtë kryqëzim të rrugëve të vendosen semafore, sepse kemi të bëjmë me rrezikun permanent dhe në anën tjetër kemi të bëjmë me një çështje, e cila është shumë e ndjeshme se andej shkojnë kufomat për në varreza etj, andaj mendoj se kjo është punë shumë e ngutshme, e cila duhet të bëhet.

### **Naime Osmani parashtoi pyetje për Drejtorinë e Shërbimëve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim**

Gjatë hartimit të projekteve për zonat rurale është kërkesë e banorëve të fshatit Besi që të futen këto projekte:

1. Ndricimi i rrugëve në të dy lagjet në Besi;
2. Eliminimi apo grumbullimi i qenëve endacak të cilët gjatë gjith vitit kanë paraqitur rrezik të madh për banorët e sidomos për fëmijët;
3. Pastrimi i disa pjesëve të fshatit nga mbeturinat, kuptohet në bashkëpunim me banorët e fshatit Besi.

### **Pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale**

Në emër të banorëve të fshatit Besi si dhe të lagjes së parë të fshatit Prugovc, ju drejtohem me kërkesë që të dal ekipi i ekspertëve edhe një herë në fshatin Besi dhe të përcaktoje vijat për rrjetin e kanalizimit për të dy lagjet në Besi si dhe në lagjen e parë të Prugovcit. Me realizimin e projektit të kanalizimit në lagjen e parë të Prugovcit do të bëhet zgjidhja e problemit të kanalizimit për familjen Maxhuni, Përbreza të fshatit Besi.

Kërkesa tjetër po nga fashti Besi ka të bëjë për rregullimin e trotuarit në rrugën Besi – Rimanishtë edhe pse hapësira është e kufizuar, por duhet të mundohemi që të gjejmë mundësi në bashkëpunim me banorët.

### **Naim Makolli, pyetje për Drejtorinë e Infrastruktures Lokale**

Pjesa e rrugëve që lidhen me rrugën “Vëllezërit Fazliu” se ashtu po thirren ato, prej rrugës ku ndahet për te ish Deponia dhe rruga që shkon për Podujevë ana e djathtë të gjitha ato rrugët deri te Sinidolli janë të pa shtruara janë rrugë me thënë as me zhavorr nuk janë të shtruara kurrë. Për këtë pyetje kërkoi përgjigje me shkrim për mbledhjen e ardhshme, se a janë të parapara për vitin 2013 ato pjesë të rrugëve me u shtruar.

**Shefki Gashi** ngriti një shqetësim rreth ndaljeve te pa vend të autobusëve të trafikut urban, i cili tha se autobusi i linjes nr.7, prej Xhamisë së Llapit e deri te Bunari i Hajratit ndalet më se 13 herë, gjithashtu edhe autobusi i lines nr. 4 prej “Taukbashqes” deri te “Shkolla teknike” ndalet më se 7 herë. Për këto veprime jo korrekte të këtyre vija të trafikut, kërkoi që shërbimi i inspektorëve të komunikacionit të jetë në nivelin më të duhur.

Sa i përket vendit të kontestuar rreth Xhamisë të Matiqani, ai vend që nga viti 1956, gjegjësisht ajo pjesë më se gjysma që është e thurur ka qenë rrugë e aty nuk mund të marre askush fletë poseduese që dikujt me ia premtuar. Përndryshe aty dokumentacion në atë pozicion kah është e thurur nuk besoj që posedon askush, vetëm nëse e ka falsifikuar.

**Feti Mehdiu** tha se shqetësimin që e shprehu z. Shaip Hajrizi rreth çështjes së ndertimit të xhamisë në Matiqan është shumë me vend. Sipas disa infomatave kam dëgjuar se punët u ndërpre, ato nuk u ndërpre, e di se ajo ka filluar të ndertohej. Për ndërprerje vetëm e kam dëgjuar si informatë zyrtare, andaj neve na takon edhe duhet të kemi informatë zyrtare edhe nga inspeksioni edhe nga ata që e kanë filluar ta ndërtojnë atë xhami. Pas asaj është mirë që mos te vonohen ato ato punë tash do ti shihni ju se si janë ose me të vërtet qenka diçka e dyshimtë rreth parcelës, dhe nuk e di se e kujt është. Është mirë që të kërkojmë një sqarim dhe të na ofrohet dokumentacioni dhe të shohim çka mendojmë që më pas të deklarohejmë.

**Besa Halimi - Zagragja** tha se në lagjen "Ilirida" ish "Tasligje", rruga "Naser Hajrizi" e cila është me gjatësi prej 200 m qytetarët e së cilës kanë bërë kërkesë 2-3 vite me radhë, megjithë vullnetin e mirë dhe pritjen e mirë të drejtorive përkatëse të Pronës dhe të Urbanizmit ajo rrugë ende nuk është shtruar, kisha dashur një përgjigje me shkrim jo me gojë se kemi biseduar mjaftë për arsyet.

**Shemsi Veseli**, fillimisht tha se e pata propozuar edhe përpara edhe më duket se është më e qëlluara që kjo pikë të jetë para rendit të ditës dhe është mirë te mendojmë siç është praktikë në Parlamentin e Kosovës 30 minuta para rendit të ditës.

Çëshjet që do ti shtroj më shumë janë të nderlidhura me Drejtorinë e Shërbimeve Publike por lidhen edhe me Drejtorinë e Inspektionit.

Gjendja e krijuar në rrugën "Rexhep Luci" si pasojë e atyre lokaleve vërtet është shqetësuese, për arsye se individët që aty po mblidhen nevoja fiziologjike i bëjnë në hyrje të banesave, ka narkoman, bëhet shumë zhurmë, etj, dhe do të ishte mire që të mendojmë dhe të reflektojmë se për neve është një interes më i madh ta mbrojmë si pjesë të lagjes. Duhet të reflektojmë së pari si Komunë që të caktojmë një lokacion diku që kush don te shkoje per t shfryre epsheet e veta ndash muzikë, ndash prostitucion ndash diçka tjetër, le të caktohen lokacionet se ku do të bëhen e jo pa kurrfarë kriteri.

Çështja tjetër e që lidhet me inspektionin është te restorani "Fjala", aty janë hequr kontejnerët është betonuar ai vend për interesa të pronarit. Kërkoj nga Drejtorati përkatës që të gjejë një vend adekuat dhe ti vendos kontejnerët.

Si çështje tejet serioze e që vlenë të diskutohet e që u potencua edhe nga z. Shaip Hajrizi problemi rreth ndertimit të xhamisë në Matiqan. Mendoj se është mire që njëherë e përgjithmonë edhe institucioni te ju tregojë vendin ku e kanë po le të jenë kush të jenë ata, andaj ne këtë rast edhe këta këta besimtarët që janë të manipuluar disa prej tyre thjesht për te ju treguar ku e kanë vendin.

Mbi institucionin mbi shtetin nuk bënë te ngritet askush hiq absolutisht d.m.th nëse është jo e falshme edhe Xhamia nëse ndërtohet në mënyrë të pa hijshme jo ligjore, d.m.th. që tash te shkojmë dhe te sfidojmë organet komunale.

**Shaip Hajrizi**, lidhur me shqetësimet e ngritura rreth kontestimit të pronës për ndertimin e xhamisë në Matiqan tha se aty asgjë nuk është e kontestueshme. Pronari i ndermarrjes "Perparimi" 9 ari i ka falur Bashkësisë islame dhe menjëherë është kryer zyrtarisht shpronësimi i parcelës.

**Mejreme Berisha** ngriti shqetësim rreth mos respektimit të itinerarit nga disa linja të trafikut urban duke cekur se disa autobus po i ndërrojnë edhe drejtimet duke mos e respektuar rregulloren e Kuvendit dhe pikrisht këtë e bën linja nr.3 "Profiti".

Ai e ka drejtimin te shkoje kah Tregu i gjelbër kah Fushë Kosova e jot e shkoje te Normalja, prandaj ai nonstop shkon andej kurrë atë rrugë nuk e bënë i zbret qytetarët dhe thotë ne jemi për Normale.

Se vetë e kam përjetuar se e kam shkollën në atë drejtim hypim në atë autobus në mëngjes edhe na zbret neve te kthesa për te për Fushë Kosovë. Prandaj ky është problem i vogël ku ndalet autobusi, por çka te bejme me ata që po i ndërrojnë drejtimet.

Për shqetësimet e ngritura rreth funksionimit të trafikut urban, **Agim Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dha sqarime të nevojshme.

*Mbledhja mbaroi në orën 15:00.*

**Procesmbajtësi,  
Zijadin Gashi**

**Zëv. Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete  
Engin Beyoglu**